



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në çështjen juridike të :

AC-I-22-0413-A0001

Komuna e Gjakovës, Gjakovë.

Paditëse/Ankuese

Kundër:

E paditura

N.SH “Barnatoret e Gjakovës” (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1073, të datës 5 korrik 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 4 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1073, i datës 5 korrik 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 15 qershor 2015, ankuesja kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ197-0001 të datës 7 maj 2015, me të cilin vendim kërkesa e paraqitur nga paditësja për pagesën e tatimeve komunale në pronë në shumën prej 19,011.93 euro ishte pranuar si e bazuar në shumën prej 13,917.56 euro, ndërsa ishte refuzuar si e pavlefshme në shumën prej 4,093.92 euro. Në ankesë theksohet se vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit është i pabazuar dhe juridikisht i paqëndrueshëm. Komuna e Gjakovës, përkatësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa caktimin e tatimit në pronën e paluajtshme e kishte bërë në bazë të ligjeve në fuqi. E njëjta i kishte propozuar gjykatës që të anulohet si i pabazuar vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit dhe të detyrohet AKP që Komunës së Gjakovës, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa t’ia paguaj shumën prej 19,011.93 euro në emër të pagesës së tatimeve komunale. Ankesës i kishte bashkëngjitur këto prova: vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ197-0001 të datës 7 maj 2015 si dhe autorizimin për përfaqësim.

Me datë 17 qershor 2021, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën theksohet se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit. Autoriteti i Likuidimit kishte vërejtur se shuma e pretenduar përmban si kamatat e rregullta edhe ashtu interesin. Gjatë vlerësimit të shumës së pretenduar, Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar vendimin e tij në dispozitat e nenit 29 të Ligjit për Administrimin e Tatimeve në Kosovë siç janë të disponueshme të nenit 18 paragrafi 5 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme që përcakton rendin e pagesës: shpenzimet e vjeljes, shuma e tatimeve për t’u paguar, dënimet, interesi. Prandaj, pasi që nuk janë identifikuar shpenzimet nga parashtruesi i kërkesës, çdo pagesë nga N.SH është konsideruar nga Autoriteti i Likuidimit së pari si mbulim për kryegjënë dhe çdo shumë i atribuohet interesit. Autoriteti i Likuidimit në rastin konkret nuk është në gjendje për të vlerësuar përqindjen e shpërndarjes përderisa të jenë dorëzuar dhe vlerësuar të gjitha pretendimet. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa e paditëses, ndërsa të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoriteti i Likuidimit.

Me datë 20 shtator 2021, gjykata kishte lëshuar një urdhër për të paditurën, AKP-në, përmes së cilit urdhër kishte kërkuar nga e njëjta të dorëzoj në DHPGJS të gjitha provat të cilat nuk janë

në shkresa të lëndës në lidhje me pretendimet e parashtrueses së ankesës, e në të kundërtën gjykata do të vendos sipas shkresave të lëndës që i ka në dispozicion.

Me datë 11 tetor 2021, AKP kishte paraqitur parashtrësë/përgjigje në urdhrin e lartcekur në të cilin thekson se Autoriteti i Likuidimit ka hulumtuar në arkivat e N.SH-së dhe nuk ka gjetur asnjë të dhënë që përputhet me ankesën e parashtrueses të datës 15 qershor 2015. Gjithashtu Autoriteti i Likuidimit thekson se në urdhrin e gjykatës nuk është cekur fare ndërmarrja për të cilën bëhet fjalë, as objekti i çështjes apo ndonjë element tjetër përmbajtësor që do të bënte të mundur për AL që të identifikohet rasti në fjalë. Gjithashtu Autoriteti i Likuidimit sqaron për gjykatën se në data bazën që e posedon nuk ka gjetur asgjë për parashtruesen e ankesës, andaj kërkon nga gjykata që t’ia përcjellë ankesën e datës 15 qershor 2015 dhe ndonjë dokument tjetër relevant që do të mundësonte identifikimin e rastit.

Me datë 20 tetor 2021, paditësja kishte paraqitur një parashtrësë të cilës i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoriteti i Likuidimit me nr. PEJ095-0002 të datës 4 nëntor 2013 të N.SH “Agimi” (në likuidim) si dhe me nr. PEJ134-0020 të datës 26 maj 2015 të N.SH “Agimi” (në likuidim).

Me datë 5 korrik 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1073 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtrueses duke vërtetuar kështu vendimin e ankimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ197-0001 i datës 7 maj 2015. Në arsyetim të këtij Aktgjykimi, gjykata kishte theksuar se nga provat e shqyrtuara gjykata kishte konstatuar se N.SH në fjalë ka hyrë në procedurë të likuidimit me datë 2 dhjetor 2013. Gjykata vlerëson se vendimi i Autoriteti i Likuidimit sipas të cilit kërkesa e Administratës Tatimore për pagesën e tatimit duke përfshirë edhe ndëshkimet në shumën prej 19,011.93 euro nga e cila është pranuar shuma prej 13,917.56 euro, ndërsa është refuzuar si e pabazuar shuma prej 5,093.92 euro, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Gjykata kishte vlerësuar se kufizimi i lartësisë së kamatës në 10% sipas nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, nga ana e ligjvënësit të çdo procesi ligjor në procedurën e likuidimit të N.SH-ve është bërë për të siguruar edhe kreditorët e renditur më ultë me përparësi pagese, t’u sigurohet edhe atyre tu paguhet diçka nga kërkesat e tyre.

Me datë 26 korrik 2022, paditësja (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-15-1073 të datës 5 korrik 2022, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës

kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të aprovet ankesa e ankueses si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet apo që i njëjti të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Në ankesë theksohet se aktgjykimi i ankimuar është i pabazuar dhe jo ligjor për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, i njëjti përmban shkelje të renda të procedurës ngase ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos për shkak se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është kontradiktor me arsyet, përkatësisht aktgjykimi i ankimuar nuk ka arsye për faktet vendimtare. Arsyet e dhëna janë kontradiktore përkatësisht për faktet vendimtare ekzistojnë kontradikta pasi që fare nuk ka vlerësuar se Komuna e Gjakovës për shkaqet e përmendura në kërkesën për rishqyrtim të ankesës.

Në rastin konkret, më rastin e aprovimit të kërkesës së ankueses është dashur të merret për bazë edhe fakti se parashtruesi i kërkesës e ka statusin juridik si Bashkësi Shoqërore-Politike në funksion të ofrimit të shërbimeve të ndryshme për qytetarët e saj, aktiviteti i së cilës financohet nga Buxheti i Kosovës i cili krahas kreditorëve të tjerë është dhe mund të jetë edhe përfitues i mjeteve që realizohen nga shitja e aseteve të N.SH-së si dhe nga burimet vetanake sipas bazave të ndryshme duke përfshirë këtu edhe të hyrat nga Tatimi në Pronë i cili ka qenë objekt i kërkesës. Tutje, ankuesja thekson se shkalla e parë ka nxjerrë Aktgjykim të ngutshëm duke mos vlerësuar drejtë deklaratimet e bazuara të ankueses e cila konsideron se AKP si Autoriteti i Likuidimit ka qenë e njëanshme në procesin e likuidimit edhe pse sipas ligjit ajo është dashur të kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe të vendos Ex officio në favor të Komunës së Gjakovës e jo të dëmtoj Komunën në këtë mënyrë. AKP ka është dashur që të mos lejoj likuidimin në fjalë meqë e njëjta si organ i likuidimit ka qenë e njoftuar dhe e detyruar që këto mjete t'ia kaloj Komunës së Gjakovës e jo të lejoj likuidimin e ndërmarjes në fjalë, veprim ky i kundërligjshëm, i anshëm dhe si i tillë i dëmshëm për autoritetin e Komunës. Ankesës i kishte bashkëngjitur një autorizim të përgjithshëm për përfaqësim.

Me datë 10 tetor 2022, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses në të cilën thekson se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura dhe i propozon Kolegjit të Apelit që të refuzoj ankesën e paditëses si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet vërtetuar.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla së parë e kishte refuzuar ankesën e paditëses si të pabazuar dhe i kishte vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së si të drejtë dhe të bazuar në ligj, me arsyetimin se në bazë të nenit 37 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit mbi AKP-në, kamatat – interesi që tejkalon 10% të shumës themelore të borxhit tatimor, është në kundërshtim me dispozitat ligjore të cituara më lartë. Shkalla e parë e DHPGJS-së përcakton se Ligj i AKP-së është mbizotërues ndaj ligjeve tjera.

Tutje Kolegji i Apelit pajtohet në tërësi me gjetjet faktike dhe konstatimet e Shkallës së parë të cilat i konsideron si të drejta dhe të bazuara në ligj.

Kolegji i Apelit nuk i pranon si të sakta pretendimet ankimore të paditëses se legjislacioni tatimor, në bazë të cilit ai e mbështet padinë i mbisundon dispozitat ligjore tjera, përfshirë edhe dispozitat e nenit 37 të Ligjit të AKP-së. NSH-ja ndaj të cilës kërkohet borxhi tatimor dhe interesat dhe kamatat ndëshkuese, është e përfshirë në procedurën e likuidimit, dhe çdo pretendim apo kërkesë monetare ndaj NSH-së në likuidim i nënshtrohet rregullave, kërkesave dhe procedurave të rregulluara me Shtojcën e Ligjit të AKP-së. Andaj është i saktë konstatimi i Shkallës së parë se ligj special në këtë rast është Ligji i AKP-së dhe Shtojca e tij, e jo legjislacioni tatimor të cilit i referohet ankuesja.

Prandaj nga këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson se nuk ka mundësi të ndryshohet rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, pasi që ky rezultat është i saktë dhe i bazuar në ligj. Shkalla e parë me të drejtë e kishte refuzuar ankesën e paditëses dhe e kishte vërtetuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Autoriteti i Likuidimit në mënyrë të drejtë e kishte zbatuar nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së nr.04/L-034, kur e kishte refuzuar kërkesën e paditësit që të paguhet interesi i kalkuluar që tejkalonte shumë prej 10%, të borxhit kryesor tatimor.

Prandaj Kolegji i Apelit pohon se paditësi ka dështuar të ofroj prova të nevojshme dhe të mjaftuara për ta mbështetur kërkesën e tij, ndërsa barra e provës në bazë të nenit 42.2 të LDHP-së dhe nenit 7 të LPK bie mbi paditësin.

Për këto arsye ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja në bazë të nenit 8.2 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22 mars 2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, Institucionet shtetërore , qendrore dhe lokale janë të është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 4 prill 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
